



Lidership

LIGJERUES: BUTRINT **BATALLI**

Lidership Përmbajtja

Lidership;

|

- ▶ Koncepti i lidershipit – Përkufizimi
- ▶ Studimet mbi trajtat dhe karakteristikat e liderit
- ▶ Model i pesë faktorëve të personalitetit dhe lidershipi



Lidership;

Koncepti i lidershipit – Përkufizimi

Studimet mbi trajtat dhe karakteristikat e liderit

Model i pesë faktorëve të personalitetit dhe lidershipi

Roli i liderit

Lidershipi

- ▶ Lidershipi sot, është prioritet i studiuesve në nivel global. Në portalin Amazon books mund të gjeni **130,868** libra që kanë si titull nocionin lidership (*10 Mars 2015*).
- ▶ Njerëzit lexojnë libra të lidershipit për shumë arsye, të inspirohen duke kuptuar sfidat që të tjerët i kanë tejkaluar, të vërtetohen se veprimet e tyre nuk janë të gabuara.



Lidershipi

- Sipas dijetarëve të teorive të evoluimit Lidershipi paraqet eksperiencë njerëzore që nga zanafilla e zhvillimit njerëzor dhe si i tillë në atë kontekst kohor ka patur karakter të mekanizmit të mbijetesës njerëzore. Nga ajo kohë mund të thuhet se lidershipi ka ndikim jashtëzakonisht të madh në sjelljen dhe cilësinë jetës së njeriut.



Lidershipi

- ▶ Lidershipi mund të definohet gjithashtu edhe nga konteksti i raporteve në mes liderit dhe pasuesve/vartësve në organizatë. Në bazë të këtij këndvështrimi, liderët posedojnë pushtet/ autoritet dhe shfrytëzojnë të njëjtin që të nxisin ndryshime tek të tjerët.

Lidershipi paraqet bërjen e gjërave të duhura. -
Peter Drucker (1909-2005)

Lidershipi është aftësia për të bërë gjëra të
jashtezakonshme nga njerëz te zakonshëm – **Brian
Tracy**

Liderët e mëdhenj

Analiza historike e ngjarjeve kyçe përfshinë mijëra raste të lidershit të mirëfilltë dhe liderëve të aftë por edhe të lidershit të gabuar.

- ▶ Nuk mund shpjegohet sukcesi ushtarak i romakëve pa iu atribuuar lidershit të Julius Cezar,
- ▶ Lufta për pavarësinë e Indisë nuk do kishte kuptim pa Mahatma Gandhi,
- ▶ Lëvizja amerikane për të drejtat e qytetarëve është e pamundur pa Martin Luther King,
- ▶ Analiza e Gjermanisë naziste pa Adolf Hitler,
- ▶ Kina Komuniste pa Mao Tse Tung,
- ▶ Suksesi i Gramen Bank në Bangladesh pa u investiguar roli i Muhamed Jonuz.



Lidership si problem dhe zgjidhje

- Lidershipi shihet **si problem por edhe si zgjidhje** të të gjitha problemeve bashkëkohore duke filluar nga lufta ndaj varfërisë deri tek ndryshimet klimaterike, lidershipi është kyç në rigjenerimin e kompanive por edhe kyç në bankrotimin e shumë kompanive gjatë krizës së fundit globale (*rastet: Lehman Brothers, City Group, Enron, Fortis*), lidershipi është kyç për regjenerimin e shumë komuniteteve por edhe për bankrotimin e tyre (rasti i fundit bankrotimit të qytetit të Detroit në SHBA).

Përkufizimi dhe komponentat e nocionit leadership

□ Çfarë është leadershipi:

Përkundrajt faktit se mbi leadershipin ekzistojnë më tepër përkufizime mund të konkludohet se disa komponentë bazë që janë të domosdoshme në përkufizimin e konceptit leadership. Në këtë kontekst leadershipi është:

- ▶ **Proces**
- ▶ **Me të realizohet ndikim**
- ▶ **Paraqitet në kontekst të grupit**
- ▶ **Niset nga premisa e realizimit të qëllimit**

proces në të cilin individi ndikon tek grupi që të realizohet qëllimi i përbashkët.



Definicione të Leadershipit

Aftësia për të ndikuar një grup drejt arritjes së qëllimeve.

LEADERSHIP ka të bëj me ...

- -Përballjen me ndryshimet që përfshijnë ...?
- Vendosjen e Drejtimit
- Menaxhimin e Njerëzve
- Motivimin & Frymëzimin



Pesë tiparet e personalitetit


Pesë faktorët ndikues në Leadership janë

- ▶ Ekstrovert
- ▶ I këndshëm/pajtueshëm
- ▶ I ndërgjegjshëm
- ▶ Neurotik
- ▶ I hapur



Ekstrovert

- ▶ Ekstravert është përcaktuar si një tipar i personave haptazi ekspresiv. me një interes të madh në njerëz të tjerë dhe ngjarjet e jashtme.
- ▶ Përfaqëson tendencë të jetë i sigurt, aktiv, dhe në kërkim të avanturës
 - ▶ Unë nuk e kam problem të jem në qendër të vëmendjes
 - ▶ Unë ndihem rehat rreth njerëzve
 - ▶ Unë inicioj bisedat
 - ▶ Unë flas me shumë njerëz të ndryshëm nëpër mbledhi



I Pajtueshëm

- ▶ Të qenit I pajtueshëm tregon nivelin se sa të përshtatshëm është kjo kategori e njerëzve me njerëz të tjerë, ose në thelb se si ata janë në gjendje për të krijuar lidhje me të tjerët
- ▶ Përfaqëson tendencat për të qenë i sjellshëm, i butë, dhe i besuar
 - i. Unë jam i interesuar në njerëz
 - ii. Une bashkëndjej me ndjenjat e të tjerëve
 - iii. Unë kam një zemër të butë
 - iv. Unë shpenzoj kohë për të tjerët
 - v. Unë I ndjejë emocionet e të tjerëve
 - vi. I bëj njerëzit të ndjehen të qetë



I Ndërgjegjshëm

- ▶ Tipari i të qenit i ndërgjegjshëm nënkupton se sa një person i konsideron rrethanat dhe njerëzit tjerë gjatë procesit të marrjes së vendimeve.
- ▶ Përfaqëson tenden për të treguar vet-diciplinë, të vepruarit sipas detyrave dhe të synoj për arritje
 - i. Unë jam gjithnjë i përgatitur
 - ii. I kushtoj vëmendje detaleve
 - iii. Më pëlqen rregulli
 - iv. I përmbahem orarit

Neurotik

- ▶ Tendenca për të përjetuar ndjenjat e pakëndshme lehtësisht siç janë: hidhërimi, ankthi, depresioni, disponim i luhatshëm
 - i. Shumë lehtë shqetësohem
 - ii. Ndryshoj disponimin shpesh
 - iii. Iritohem lehtë
 - iv. Stresohem lehtë
 - v. Brengosëm për gjëra të ndryshme



I Hapur

- ▶ I hapur I referohet se sa janë njerëzit të gatshëm për të bërë përshtatje në nocione apo veprime në pajtim me situatat dhe idetë e reja
- ▶ Përfaqëson tendencën për të qenë kreativ, me imagjinatë, përceptues dhe mendjeplotë
 - i. Unë kam imagjinatë të bujshme
 - ii. Kam ide të shkëlqyera
 - iii. I kuptoj gjërat lehtësisht
 - iv. Kaloj kohë duke reflektuar
 - v. Kam plotë ide



Pushteti dhe Lidershipi

- ▶ Pushteti nënkupton kapacitet të një personi të prodhoj efektin e paraparë në raportet me të tjerët. Pushteti nënkupton interaksion që duhet të ketë qëllim dhe efekt. Pushteti nuk është posedim. Njeriu nuk ka pushtet ai/ajo ushtron pushtet. Pushteti është eksperiencë e relacioneve dhe varet nga interaksioni me të tjerët



Përparësi strategjike e Leadershipit

- ▶ shpjegimi i ashtuquajtur „**përparësi strategjike**„ nënvizon faktin se leadershipi është një lloj aset (vlerë/pasuri) që duhet të kultivohet nëse organizata/kompania/komuniteti dëshiron të ketë përparësi krahasuese ndaj konkurrentëve.



Lidershipi - konkluzion

- ▶ lidershipi nuk është proces linear dhe një-kahesh por është një fenomen interaktiv. Kur lidershipi definohet në këtë formë pozita e liderit është e kapshme për të gjithë jo vetëm për liderin formal në grup.
- ▶ Lidershipi nënkupton ndikim dhe prandaj është me rëndësi të vlerësohet mënyra se si lideri ndikon tek pasuesit/vartësit
- ▶ Me lidership nënkuptohet edhe drejtimi në realizimin e qëllimeve.
- ▶ Lidershipi „**paraqet proces me të cilin individi ndikon tek grupi i individëve në arritjen e qëllimit të përbashkët**”. Bernard Bass



Përgatiti: Butrint BATALLI

Email: butrint@inovaconsulting.eu